Për të adresuar problemin e diferencave të mëdha në numrat e popullsisë së ofruara nga Regjistri i Gjendjes Civile (RGJC) dhe Censusi i vitit 2011, në formulën e re është bërë një zgjidhje kompromisi që harmonizon të dhënat për popullsinë. Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censurit të vitit 2011, të azhuruara me normën e rritjes së popullsisë në nivel qarku sipas vlerësimit të bërë nga INSTAT në vitin 2014. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censurit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2014) për secilën njësi të qeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e qeverisjes vendore sipas Censurit të vitit 2011 (të azhuruar me normën rajonale të rritjes së popullsisë në vitin 2014) ka 30.000 banorë, ndërsa sipas gjendjes civile rezultojnë të ketë 45.000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë $30.000 + [(45.000 - 30.000) * 30\%] = 34.500$ banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të qeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezultojnë rreth 3.3 milion banorë, nga 2.9 milion që raportohet nga Censusi dhe 4.3 milion që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm, dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censurit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Bashkitë.

Për vitin 2016, transferta e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë e reja është **11.393.248.132 Lekë** dhe do të ndahet sipas kriterëve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulën e re kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësisë të ndryshme qeverisjes mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulën e re 80% e transfertës për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censurit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe



të dhënave të Censurit, çdo njësi e qeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 3.078 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e qeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë	11.393.248.132
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	80%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	9.114.598.506
Transferta e pakushtëzuar për frymë	2.733

Reforma administrative territoriale ka eliminuar dallimet ligjore mes komunave dhe bashkive duke i bërë 61 bashkitë e reja shumë më të ngjashme me njëra tjetrën për sa i përket sipërfaqes dhe popullsisë nga sa ishin në ndarjen e vjetër territoriale. Si rezultat, sipërfaqja dhe popullsia nuk shprehin më ndryshime thelbësore në strukturën e njërive vendore që mund të nënkuptojnë kosto – mesatarisht - më të mëdha ose më të ulta se njësitë e tjera. Për të marrë në konsideratë diferencat në kostot e ofrimit të shërbimeve në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore, njësitë e qeverisjes vendore diferencohen mbi bazën e dendësisë së popullsisë.

Në fakt, dendësia e popullsisë është më e ulët në bashkitë e reja që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Kjo do të thotë se alokimi i një pjese të transfertës për bashkitë me dendësi të ulët popullsie do të drejtohej në të njëjtat zona të vendit që merrnin financim nga komponenti i sipërfaqes në formulën e vjetër, edhe pse sipërfaqja e tyre tashmë është mjaft e ngjashme me ato të bashkive më të populluara. Për më tepër, ka një korrelacion të fortë mes njërive të qeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Si rezultat, koeficienti, “dendësi e ulët e popullsisë”, çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e vjetër, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulën e re, 15% e totalit të fondit për bashkitë, alokohet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, dhe përfitues janë njësitë e qeverisjes vendore që kanë një dendësi popullsie nën 110% të mesatares kombëtare prej 118 banorë për km².

Komponenti II: ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							15%
Madhësia e Transfertës së Pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							1,708,987,220
Mesatarja Kombëtare e Dendësisë së Popullsisë (banorë/km ²)							118
Transferta per fryme nga densiteti i popullsisë							1.532
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët e rregullimit	Numri u NJQV-ve përfituese	Dendësia e popullsisë korresponduese	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrektuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup	
Kufiri 1	22%	11	25,9	126.862	253.724	388.689.156	
Kufiri 2	44%	12	51,7	278.541	445.665	682.729.994	
Kufiri 3	75%	10	88,1	353.121	300.152	459.814.078	
Kufiri 4	110%	6	129,3	290.081	116.032	177.753.992	
	>110%	0	0	0	0	0	
Totali		39		1.048.604	1.115.574	1.708.987.220	



Një njësi e qeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 4 grupime të njësive të qeverisjes vendore sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullore përfitojnë nga koeficientët shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë rreth 39 njësi të qeverisjes vendore, në të cilat banojnë rreth 1 milion banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e qeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km², atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me dy. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.6. Pra duke u afruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **1,532 lekë** për banorë, (që rezulton nga pjesëtimi i shumës prej **1,708,987,220 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Kriteri i tretë mbi të cilin do të ndahet transfertat e pakushtëzuar për bashkitë është numri i nxënësve në shkollat publike nëntë-vjeçare dhe të mesme. Për vitin 2016, 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar, ose 569.622.407 lek do të alokohen mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 1,278 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.

Komponenti III: ndarja sipas numrit të nxënësve (në përqindje)	5%
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të nxënësve, në lek	569.662.407
Vlera e transfertës së pakushtëzuar të ndarë për çdo nxënës	1.278

6. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm.

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të qeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulën e re llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë të cilat mbledhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njësive vendore. Në këtë mënyrë njësitë e qeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit duke evituar kështu çdo lloj disincentivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2014, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësive të qeverisjes vendore është 3.1 miliard lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 930 lekë për banor, sipas konceptit “banor rezident efektiv”.

Komponenti IV: Sistemi I Ekualizimit të të ardhurave						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (Biznesi i Vogël + Taksa e Automjeteve + Taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						3.100.380.861
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						930
Nëse NJQV-të kanë TAPF	75%	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	100%	të diferencës	Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	383.807.757



duke u marrë NJQV-ve me të ardhura për frymë mbi	110%	të mesatares kombëtare (TAKPF)	50%	të diferencës	Fondet që efektivisht shkurtohen	411.331.405
Koeficienti i rishpërndarjes						1.07

Në formulën e re, njësitë e qeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 75% mesatares kombëtare (TAKPF) prej 930 lekë/frymë, do të kompensohen me 100% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t'u shtoheshin njësite me të ardhura më të ulta për ti sjellë ato në nivelin prej 698 lek/frymë (ku $930 \times 75\% = 698$ lek). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulta” në nivelin prej 75% të mesatares kombëtare, njësite me të ardhura më të larta se 110% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 1023 lekë/frymë) do t'u merret 50% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 110% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi vendore ka të ardhura për frymë prej 1400 lek/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do ti zbriten 189 lek/frymë $\{[(1400 - (110\% \times 930)) \times 50\% = 189 \text{ lek/banor}]\}$. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ultat. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2016, fondet e nevojshme për ekualizim janë 383.807.757 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga “taksimi” prej 50% të të ardhurave mbi 1023 lek/frymë i njësite me të ardhura më të larta janë 411.331.405 Lek dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 1.07.

Në të njëjtën mënyrë, vetëm për vitin 2016, si vit i parë i aplikimit të formulës së re do të përdoret një mekanizëm tranzitor që do të sigurojë që të gjitha njësitë e qeverisjes vendore do të marrin minimalisht 85% të transfertës që kanë marrë vitin e mëparshëm. Kështu, bashkitë që për vitin 2016 rezultojnë të kenë një transfertë më të lartë se 15% në raport me transfertën e marrë në vitin 2014, do të kontribuojnë me diferencën mbi kufirin prej (+15%), për të krijuar një fond të ekualizimit të transfertës prej 143.916.863 lekë gjithsej. Në të njëjtën kohë, njësitë e qeverisjes vendore që kanë një transfertë më të ulët se ajo e marrë në vitin 2014, do të kompensohen përpjesëtimisht sipas koeficientit të rishpërndarjes rezultues nga raporti i fondeve të disponueshme dhe fondeve të nevojshme. Në përfundim, të gjitha njësitë vendore do të marrin minimalisht 85% të transfertës që kanë marrë vitin e mëparshëm dhe kjo garanci do të paguhet nga njësitë me një transfertë mbi 15% në raport me vitin 2014.

Komponenti V: Ekualizimi i grandit në lidhje me vitin e kaluar						
Nëse NJQV-të kanë grandin final më të lartë	15%	Në lidhje me vitin e kaluar, atëherë duhet të kontribuojnë me	100%	Të diferencës mbi kufirin e krijuar nga ekualizimi i grandit		143.916.836
Nëse NJQV-të kanë një grand më të vogël se ai i vitit të kaluar, atëherë NJQV-të do të kompensohen për diferencën nga ekualizimi i transfertes se pakishteuar						195.373.885
Koeficienti i rishpërndarjes						0.74



7. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet.

Reforma administrative-territoriale nuk i konsolidoi qarqet. Këtyre të fundit nuk u është kaluar ndonjë funksion shtesë me reformën administrative territoriale. Përkundrazi, përgjegjësia për rrugët rajonale do të kalojë tek bashkitë e reja. Për rrjedhojë, Qarqeve do t'u alokohen 440 milionë lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 Qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 88 milion lek) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 7.3 milion lek për të 12 Qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	440.000.000
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	20%
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	88.000.000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	7.333.333

Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 220 milion lek) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)	50%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	220.000.000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (Banorë rezidentë efektivë)	66

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 132 milion lek) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)	30%						
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë	132.000.000						
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë	118 banorë/km ²						
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë	165 lek/banorë						
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët	Numri i Qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup	
Kufiri 1	90%	0,3	4	105,8	918.119	45.426.831	34%
Kufiri 2	65%	0,5	3	76,4	668.919	55.161.430	42%
Kufiri 3	35%	1,0	2	41,1	190.458	31.411.739	24%

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 118 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 165 lek për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 15,375,289 lek (i llogaritur në këtë mënyrë: 93.225*1*165).



ANEKS 2
Kriteret e Shpërndarjes së Fondit Rezervë

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	<ul style="list-style-type: none">• Kompensim për ndonjë gabim në përlogaritjen e kriterëve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2016.• Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë për vitin 2016.• Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	<ul style="list-style-type: none">• Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësite e qeverisjes vendore nuk duhet të kaloj 50 për qind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2016.

Pjesa e papërdorur e fondit të kompensimit në vitin buxhetor 2016, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2017.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2016.

**ANEKS 4****Per funksionet që financohen me transferta specifike për vitin 2016****1. Konviktet e arsimit parauniversitar**

Në transfertën specifike të vitit 2016, disa bashkive ju akordohen fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, date 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, date 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendës drejtor dhe edukator).

Ministria e Arsimit dhe Sportit para fillimit të vitit fiskal 2016, duhet të dërgoje në njësitë e qeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e qeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën specifike të vitit 2016 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Kuçovë dhe Kukës janë fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për Bashkinë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Kuçovë dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Punëve të Brendshme, duhet të transferojë në bashkitë përkatëse, inventarin e mjeteve, godinave dhe aseteve të tjera. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Brendshme duhet t’ju dërgoj bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.



4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, para fillimit të vitit fiskal 2016, duhet të dërgoje në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

Këshillat e qarqeve para fillimit të vitit fiskal 2016, duhet të dërgojnë në bashkitë përkatëse, kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: rrugët rurale rajonale të transferuara në bashki, dosjet personale të punonjësve, mjetet dhe asetet sipas një plani të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Mjedisit, para fillimit të vitit fiskal 2016, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin.

Gjithashtu, Ministria e Mjedisit duhet t'ju dërgoj bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor, mjetet, asetet dhe të dhëna të tjera që disponon, të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.



Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, para fillimit të vitit fiskal 2016, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin.

Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave duhet t'ju dërgoj bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor, mjetet, asetet dhe të dhëna të tjera që disponon, të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

ANEKSI 5
Shpërndarja e grantit të Arsimit të Lartë

Kriteret e formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar të financimit nga buxheti i shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë-viti 2016			
Artikulli buxhetor, simboli dhe llogaritja	Koefficienti	Vlera (në mijë lekë)	Përshkrimi
1. Shuma totale për transferimet e pakushtëzuara për institucionet publike të arsimit të lartë			
Shuma totale për transfertat e pakushtëzuara [T]	100%	5,273,317	Sipas paragrafit 1 të nenit 76 të ligjit nr. 9741 Për Arsimin e Lartë (Ligji) transfertat nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL) jepen si transfertat të pakushtëzuara dhe si transfertat me konkurrim për investime. Shuma në këtë rresht paraqet shumën totale të marrë nga buxheti për transfertat e pakushtëzuara. Paragrafi 1 i nenit 44 përcakton që shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet në një formulë që garanton barazi, drejtësi dhe transparencë.
2. Ndarja bazë e sasisë totale për transfertën e pakushtëzuar për qëllime shpërndarjeje			
Shuma për paga dhe sigurime [P dhe S] = [T]*0,90	90%	4,745,985	Në fillim të procesit së përcaktimit të transfertave të pakushtëzuara për IAL-të e veçanta, MAS-i e ndan sasinë totale për transfertat e pakushtëzuara në 4 pjesë: shuma për paga dhe sigurime, shuma për për mallrat dhe shërbimet për arsimin dhe funksionimin, shuma për kostot specifike të institucionit dhe shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për kërkimet. Secila prej këtyre pjesëve ndahet veçmas midis IAL-ve të veçanta duke përdorur procedura të ndryshme. Transferata e llogaritur për cdo IAL është shuma e sasisë së llogaritur për një IAL konkret, për secilën nga të katërt pjesët e përmendura më lart. Paraqitja e kësaj ndarjeje të brendshme është e nevojshme për të siguruar barazinë, drejtësinë dhe transparencën e të gjithë procesit të shpërndarjes. Përqindjet e përdorura për ndarjen në katër pjesë pasqyrojnë nevojat e IAL-ve dhe politikën e MAS-it.
Shuma për mallrat dhe shërbimet për arsimin dhe funksionimin [A dhe F] = [T]*0,5	5%	263,666	
Shuma për kostot specifike të institucionit dhe të zhvillimit [S dhe ZH] = [T]*0,02	2%	105,466	
Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për kërkimet [IK] = [T]*0,03	3%	158,200	
3. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së sasisë për paga dhe sigurime			
Shuma për pagat dhe sigurimet e punonjësve ndihmës [P dhe S_PN] = [P dhe S_PN_2011]*1,05=(238394*1.05)=250,314 mijë leke		262,830	Për qëllime shpërndarjeje, sipas paragrafit 2 të nenit 46 të ligjit, personeli administrativ ndahet në punonjës profesionistë, punonjës ndihmës dhe punonjës administrativë. Punonjësit ndihmës përfshijnë punonjësit që kryejnë detyra të përgjithshme operacionale (p.sh. rojet, shoferët, zjarrfikësit, pastruesit dhe personeli i mirëmbajtjes). Meqë nevoja objektive e këtij stafi varet së tepërmi nga specifikat e IAL-së, metoda e indeksimit nga shpërndarja e vitit të mëparshëm përdoret për këtë kategori. (numri i punonjësve i parashikuar për vitin 2015-2016)
Struktura bazë për paga dhe sigurime [P dhe S_SB] = 30 000 000. Lekë * 13 IAL (UT, UMT,UPT,UBT, UA, US, USH, AA, UD, UE, UK, UGJ, UV)	sasia fikse 30 000 000 Lekë për IAL	390,000	Për secilin IAL caktohet një shume si një strukturë bazë për paga dhe sigurime. Kjo masë është e nevojshme për shkak të ekzistencës së IAL-ve të vogla në sistem.
Shuma për paga dhe sigurime për punonjësit e mesimdhënies shkencore, punonjësit administrativë dhe për punonjësit profesionistë e caktuar në përputhje me performancën e IAL-së në arsim. [P dhe S_PP] = ([P dhe S] - [P dhe S_PN] - [P dhe S_SB])*0,85	85%	3,479,182	Caktimi i pjesës më të madhe për paga dhe sigurime ndahet në 2 pjesë: 85% e shumës caktohet në përputhje me performancën e një IAL-ve të vetme në arsim dhe 15% në përputhje me performancën në kërkime. Shuma në këtë rresht caktohet në përputhje me performancën në arsim, që vlerësohet duke përdorur numrin e studentëve ekuivalentë me kohë të plotë (EKP) dhe numrin e të diplomuarve EKP në fusha studimi individuale duke marrë në konsideratë kërkesat për personel të arsimit në ato fusha studimi, të shprehura nga koeficienti i kërkesave personale (KKP). Gjithashtu merret në konsideratë edhe struktura e kualifikimit të stafit akademik. Ideja kryesore pas kërkesave për personel qëndron në faktin që fushat e veçanta të studimit ndryshojnë aq sa numri i studentëve që mund të mësohen nga një mësues (mesatarisht).
Shuma për paga dhe sigurime për punonjësit e mesimdhënies shkencore, punonjësit administrativë dhe punonjësit profesionistë e caktuar në përputhje me performancën e IAL-së në kërkime [P dhe S_PK] = ([P dhe S] - [P dhe S_PN] - [P dhe S_SB])*0,15	15%	613,973	Vlerësimi i performancës së kërkimeve në 2011 bazohet në 3 tregues (për vitet e ardhshme, përgatiten 6 tregues): niveli i përvetësimit të granteve për kërkime nga burime të brendshme, përmasat e studimeve të doktoraturës të shprehura nga numri i të diplomuarve dhe kapaciteti i kërkimeve i shprehur nëpërmjet numrit të profesorëve me kohë të plotë. Arsyetja objektive e përdorimit të pjesshëm të performancës së kërkimeve për caktimin e sasisë për paga dhe sigurime është fakti se aktiviteti i kërkimeve është pjesë themelore e punës së personelit akademik.



4. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së shumës për mallra dhe shërbime			
Shuma për mallra dhe shërbime për arsimin [M dhe SH_A] = [M dhe SH]*1/3	33.33%	87,880	Shpenzimet për mallra dhe shërbime mund të ndahen në shpenzime që varen nga fusha e studimit dhe në shpenzime që nuk varen prej tyre (pra, ngrohje, ndriçim). Raporti i këtyre pjesë në formulë përcaktohet në 1:2. Pjesa e parë titullohet mallra dhe shërbime për arsimin. Sasia e kësaj pjese është në këtë rresht dhe caktohet në përputhje me numrin e studentëve EKP të llogaritur nga koeficienti i kërkesave ekonomike (KKE). KKE-ja tregon kërkesat për kostot jopersonale të fushës përkatëse të studimit
Struktura bazë për mallra dhe shërbime për funksionimin [M dhe SH_SB] = 10 000 000 Lekë * 11 _IAL	66.67%	110,000	Pjesa e dytë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime titullohet mallra dhe shërbime për funksionimin. Për secilin IAL, sasia e kësaj pjese përbëhet nga një strukturë fikse bazë dhe një pjesë e caktuar në mënyrë proporcionale me numrin e studentëve EKP. Masa e strukturës bazë është e nevojshme për shkak të ekzistencës së IAL-ve të vogla në sistemin.
Shuma për mallra dhe shërbime për funksionimin [M dhe SH_0] = [M dhe SH]*2/3 - [M dhe SH_SB]		65,786	
5. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së shumës për kostot specifike të institucionit			
Shuma për kostot specifike të institucionit dhe të zhvillimit [S dhe ZH]	3%	105,466	Meqë mund të ekzistojnë raste të kostove specifike të IAL-ve që nuk janë të mbulura nga pjesë të tjera të formulës, formula mundëson shpërndarjen e një shumë për raste të tilla. Fondet për vende të veçanta pune ose mësimdhënie praktike në disa fusha janë një shembull i kostove specifike. Shpërndarja në këtë pjesë realizohet në bazë të kërkesave individuale të dorëzuara nga IAL që përbajnë arsytetime dhe llogaritje kostosh për aktivitetet për të cilat kërkohet financimi. Shpërndarjet për kostot specifike të institucioneve limitohen vetëm ndaj artikujve jo standardë. Shuma e paraqitur në këtë radhë është një rezervë për kostot specifike të institucioneve në 2016. Një pjesë e shumës në këtë radhë gjithashtu mund të përdoret për shpenzime aktuale të projekteve zhvillimore të dorëzuara nga IAL-ja dhe të aprovuara nga MAS-i.
6. Ndarja dhe metoda e shpërndarjes së sasisë për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore			
Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore të shpërndarë sipas granteve të kërkimit nga burime të brendshme [IK_G.J]. = [IK]*1/3	33.33%	52,733	Përfshirja e shumës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore në formulë vjen nga angazhimi i fortë ndaj zbatimit të ligjit ku arsimi universitar duhet të bazohet në kërkime dhe njohuri shkencore dhe teknologjike bashkëkohore. Mbështetja për projektet e mirëfillta kërkimore ofrohet në mënyrë konkurruese nga burime të tjera të ndryshme. Por është e rëndësishme për IAL-në që gjithashtu të kenë disa fonde për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së përbashkët kërkimore. Për arsye të një lidhjeje të ngushtë midis arsimit dhe kërkimit, një pjesë e këtyre fondeve duhet të ofrohet brenda transfertave të pakushtëzuara. Shpërndarja e shumës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore ndaj një IAL-je të vetme bazohet në performancën e kërkimit të vlerësuar duke përdorur kriteret dhe vlerat e paraqitura në këto rreshta. Shuma për këtë pjesë, e cila është 5% për vitin 2016, është planifikuar të rritet në vazhdim në vitet e ardhshme.
Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore të shpërndarë sipas të diplomuarëve të studimeve të doktoraturës [IK_GB]. = [IK]*1/3	33.33%	52,733	
Shuma për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore të shpërndarë sipas kapacitetit kërkimor [IK_KK]. = [IK]*1/3	33.33%	52,733	
7. Minimumi i garantuar			
Minimumi i garantuar [MG] _Minimumi i garantuar shtese deri ne 3% me shumë ndaj realizimit të buxhetit per vitin 2014.		Minimumi i garantuar deri ne 3%, ndaj buxhetit 2015	Në prezantimin e sistemeve të reja të financimit, është e nevojshme të sigurohet që ndryshimi në krahasim me sistemin e mëparshëm nuk do të jetë "shkatërrues" për asnjë subjekt. Për këtë arsye formula përmban një masë të quajtur minimumi i garantuar që siguron që transfertat finale e pakushtëzuar për 2016 për secilin IAL do të jetë të paktën përqindja e specifikuar e shumës korresponduese që IAL ka marrë nga buxheti i shtetit në 2016. Kjo shumë quhet minimumi i garantuar për IAL-në. Mekanizmi funksionon në mënyrë të atillë që për IAL-të për të cilat transfertat e pakushtëzuar e përcaktuar paraprakisht nga formula është me e ulët se sa minimumi i tyre i garantuar, transfertat finale e pakushtëzuar për 2016 i përshatet kësaj vlere në kurriz të IAL-ve me transfertat paraprake më të larta sesa minimumi i tyre i garantuar. Impakti i këtij kompensimi ndaj IAL-së mbi minimumin e garantuar bëhet në mënyrë proporcionale ndaj rritjeve në lidhje me vlerat përkatëse të minimumit të garantuar.
8. Vështrim mbi të ardhurat personale të IAL-ve			
Koeficienti i aftësisë për të siguruar të ardhura [KASA]			Sipas ligjit, IAL-të mund të mbajnë të gjitha të ardhurat dytësore nga shërbimet që sigurojnë. Formula përmban një mjet për ekuilibrimin e ndryshimeve objektive IAL-ve për sa i përket aftësisë së tyre për të siguruar të ardhurat dytësore nga shërbimet, të quajtur koeficient i aftësisë së sigurimit të të ardhurave (KASA). Ky koeficient duhet të shprehë ndryshimet në të ardhurat të dhëna kryesisht nga rregullat e jashtme, përgjithësisht të ardhurat e siguruara nga tarifrat që lidhen me studimet, por jo ndryshimet që vijnë si rezultat i shkallëve të ndryshme të gatishmërisë dhe përpjekjeve të IAL-së për të ushtruar veprimtari që sigurojnë të ardhura. Vlera e plotë e këtij koeficienti, dmth, vlera 1 - KASA, është përdorur në llogaritjen e numrit të nxënësve me kohë të plotë. Vlera për IAL-të individuale për vit të dhënë, përcaktohet si raporti i të ardhurave të ardhurat dytësore nga shërbimet dhe buxhetit total të IAL-së në vitin ushtrimor. Kështu vlera 1-KASA për IAL është de facto vlera e kontributit të buxhetit shtetëror në buxhetin e IAL-së. KASA-t duhet të rillogariten çdo vit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 546 lekë